



**LIGJ**  
**Nr. 29/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË ITALISË PËR  
MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË  
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.3.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9045, datë 10.4.2015  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE**  
**PËRMBROJTJEN E NDËRSJELLËTË**  
**INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane (më poshtë të quajtura “Palët”),

*duke pranuar* rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për stabilizimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit të ndërsjellë;



*duke pranuar* se bashkëpunimi i mirë kërkon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Palëve;

*duke pranuar* nevojën për vendosjen e rregullave në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer brenda sferës së bashkëpunimit politik, ushtarak, ekonomik, ligjor, shkencor dhe teknologjik apo tjetër, si dhe informacionit të klasifikuar në procesin e këtij bashkëpunimi në përputhje me rregulloret kombëtare të Palëve, si dhe angazhimet e tyre ndërkombëtare dhe për Italinë, me ato që rrjedhin nga anëtarësimi në BE;

*me synim* garantimin e mbrojtjes reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar që është klasifikuar nga një Palë dhe i është transferuar Palës tjetër;

*me dëshirën* për të vendosur rregulla për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar që do të shtrihet për të gjitha marrëveshjet mbi bashkëpunimin që do të lidhen ndërmjet Palëve dhe kontratat që do të jepen ndërmjet organizatave të Palëve, të cilat parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

#### **Përkufizime**

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” është çdo informacion, regjistrim, aktivitet, material, duke përfshirë objektet dhe mjediset, të cilëve u është dhënë klasifikimi i sigurisë në pajtim me legjislacionet e brendshme.

2. “Palë pritëse” është Pala së cilës i transmetohet informacioni i klasifikuar.

3. “Pala e origjinës” është Pala që nis informacionin e klasifikuar.

4. “Palë e tretë” është çdo shtet, organizatë ndërkombëtare ose subjekt juridik që nuk është palë në këtë Marrëveshjeje.

5. “Autoriteti kompetent i sigurisë” do të thotë autoriteti, i cili në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës përkatëse, përmbush politikën shtetërore për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ushtron kontroll të përgjithshëm në këtë sferë, si dhe kryen zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Këto autoritete janë renditur në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Parimi i “Nevojës për njohje” është domosdoshmëria për të pasur akses në informacionin e klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare dhe/ose përmbushjen e një detyre zyrtare konkrete.

7. “Leje sigurie personeli” është dokumenti i dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë, për një shtetas të një Pale për akses tek informacioni i klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të sigurisë.

8. “Kontratë e klasifikuar” është marrëveshja ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve shtetërore ose subjekteve juridike që krijon dhe përkufizon të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre, të cilat përmbajnë dhe nënkuptojnë aksesin të një informacioni i klasifikuar dhe të cilave u është dhënë një nivel klasifikimi sigurie.

9. “Kontraktor” është një subjekt, fizik ose juridik, që ka zotësinë juridike për të lidhur kontrata të klasifikuara.

10. “Leje sigurie strukture” është dokumenti i dhënë nga autoriteti kompetent i sigurisë, i cili konfirmon që subjekti juridik është i autorizuar të trajtojë dhe të menaxhojë informacion të klasifikuar të një nivel i caktuar klasifikimi, në pajtim me legjislacionin përkatës të brendshëm për sigurinë.

11. “Vizitorë” janë përfaqësues zyrtarë të një Pale, që kërkojnë të vizitojnë objektet dhe mjediset e Palës tjetër, të përfshira në aktivitete që lidhen me informacionin e klasifikuar.

12. “Shkelje e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, që rezulton ose mund të rezultojë në akses të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

#### Neni 2

#### **Qëllimi dhe zbatueshmëria**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është garantimi i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe vendosja e procedurave dhe rregullave të përbashkëta, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet Palëve dhe ndërmjet subjekteve publike dhe private të Palëve, në lidhje me çështjet ndërkombëtare, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, sferën industriale dhe çdo sferë tjetër aktiviteteve.



## Neni 3

**Nivelet e klasifikimit të sigorisë**

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të sigorisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigorisë të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm të Palës përkatëse:

Për Republikën e Shqipërisë	Për Republikën Italiane	ekuivalenti në anglisht
TEPËR SEKRET	SEGRETISSIMO	TOP SECRET
SEKRET	SEGRETO	SECRET
KONFIDENCIAL	RISERVATISSIMO	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	RISERVATO	RESTRICTED

## Neni 4

**Autoritetet kompetente të sigorisë**

1. Autoritetet kompetente të sigorisë së Palëve janë si më poshtë:

- Për Republikën e Shqipërisë

Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

- Për Republikën Italiane

Departamenti i Informacionit për Sigurinë - Organi i Sigurisë Kombëtare

2. Autoritetet Kompetente të Sigurisë njoftojnë njëra-tjetrën për legjislacionin e brendshëm të sigorisë në fuqi, që rregullon mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim i ngushtë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të sigorisë mund të zhvillojnë konsultime me kërkesën e bërë nga një prej tyre.

4. Çdo Palë njih reciprokisht certifikatat e sigorisë së personelit dhe certifikatat e sigorisë industriale, të lëshuara në pajtim me legjislacionet e brendshme.

5. Me kërkesë, autoritetet kompetente të sigorisë, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, ndihmojnë njëri-tjetrin në shkëmbimin e të dhënave përkatëse, për procedurat e certifikatave të sigorisë së personelit dhe certifikatave të sigorisë industriale.

6. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standardet e krahasueshme të sigorisë, autoritetet përkatëse kompetente të sigorisë, me kërkesë, i japin njëri-tjetrit informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikatat e sigorisë, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të zbatuara nga Pala përkatëse.

## Neni 5

**Parimet e sigorisë**

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, Palët zbatojnë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që gjenerohet ose shkëmbet zakonisht sipas kësaj Marrëveshjeje. I njëjti nivel mbrojtjeje sigurohet për këtë informacion të klasifikuar, siç parashikohet për informacionin e klasifikuar të brendshëm, me nivelin përkatës të klasifikimit të sigorisë.

2. Aksesin në informacionin e klasifikuar kufizohet tek ata persona që kanë nevojë për njohje, pasi të kenë marrë lejen e sigorisë nga autoriteti kompetent i sigorisë dhe të jenë informuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, në përputhje me nivelin e kërkuar të klasifikimit të sigorisë të informacionit, i cili aksesohet.

3. Pala pritëse është e detyruar:

a) të mos i japë informacion të klasifikuar një Pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës së origjinës;

b) t'i vendosë informacionit të klasifikuar nivelin e klasifikimit të sigorisë, të barasvlershëm me atë të parashikuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe në vazhdimësi të garantojë mbrojtjen në pajtim me legjislacionet e brendshme;

c) të mos e përdorë informacionin e klasifikuar për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është dhënë.

4. Parimet e mbrojtjes reciproke të informacionit të klasifikuar, të rëna dakord ndërmjet Palëve, zbatohen në të gjitha marrëveshjet dhe masat e tjera për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Palëve.

## Neni 6

**Transmetimi i informacionit të klasifikuar**

1. Informacioni i klasifikuar deri në dhe, duke përfshirë nivelin “SEKRET / SEGRETO / SECRET” transmetohet nëpërmjet kanaleve diplomatike ose me shërbime korrieri ushtarak apo tjetër, të miratuar nga autoritetet kompetente të sigorisë së Palëve. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar nga niveli “KONFIDENCIAL/RISERVATISSIMO/CONFIDENTIAL” e lart. Informacioni i



klasifikuar “TEPËR SEKRET/SEGRETISSIMO/TOP SECRET” dërgohet vetëm nëpërmjet kanaleve të certifikuara ushtarake ose diplomatike.

2. Nëse duhet të transmetohet një paketë e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet përkatëse kompetente të sigurisë bien bashkërisht dakord dhe miratojnë me shkrim mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për çdo rast të tillë.

3. Mjetet e tjera të miratuara të transmetimit ose të shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, duke përfshirë mjetet elektromagnetike, mund të përdoren nëse bihet dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë.

#### Neni 7

##### **Shënjimi i informacionit të klasifikuar**

1. Pala pritëse shënjon informacionin e klasifikuar me shënjimin përkatës të klasifikimit në pajtim me nenin 3.

2. Kopjet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë shënjohen dhe trajtohen në të njëjtën mënyrë, si dhe origjinalet.

#### Neni 8

##### **Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar**

1. Informacioni i klasifikuar i shënuar me një nivel të klasifikimit të sigurisë “TEPËR SEKRET/SEGRETISSIMO/TOP SECRET” lejohet për përkthim dhe kopjim vetëm me lejen me shkrim të autoritetit përkatës kompetent të sigurisë të Palës së origjinës.

2. Të gjitha kopjet e riprodhuara të informacionit të klasifikuar shënjohen me shënjimin e klasifikimit origjinal. Ky informacion i riprodhuar vendoset nën të njëjtin kontroll, si dhe informacioni origjinal. Numri i kopjeve kufizohet tek ai që kërkohet për qëllime zyrtare.

3. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar bëhen nga individë me leje sigurie. Përkthimi shënjohet me shënjimin e klasifikimit origjinal dhe mban një shënim të përshtatshëm në gjuhën në të cilën është përkthyer që përkthimi përmban informacion të klasifikuar të Palës së origjinës.

#### Neni 9

##### **Asgjësimi i informacionit të klasifikuar**

1. Informacioni i klasifikuar asgjësohet, në pajtim me legjislacionet e brendshme, për të mënjeluar rindërtimin e tij të plotë ose të pjesëshëm.

2. Informacioni i klasifikuar “TEPËR SEKRET/SEGRETISSIMO/TOP SECRET” nuk asgjësohet. Ai i kthehet Palës përkatëse të origjinës.

3. Pala e origjinës, me anë të shënjjimit shtesë ose dërgimit të njoftimit pasues me shkrim, mund të ndalojë shprehimisht riprodhimin, ndryshimin ose asgjësimin e informacionit të klasifikuar. Nëse ndalohet asgjësimi i informacionit të klasifikuar, ai i kthehet Palës së origjinës.

4. Në rastin e një situatë krize, informacioni i klasifikuar, i cili është i pamundur të mbrohet ose t’i kthehet Palës së origjinës, asgjësohet menjëherë në pajtim me legjislacionet e brendshme. Pala Pritëse njofton Palën e origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

#### Neni 10

##### **Kontratat e klasifikuara**

1. Kontratat e klasifikuara lidhen dhe zbatohen në pajtim me legjislacionin e brendshëm të secilës Palë. Me kërkesë, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës Palë, jep konfirmim me shkrim që një kontraktor i propozuar është pajisur me një certifikatë të përshtatshme kombëtare të sigurisë industriale, sipas nivelit të kërkuar për klasifikimin e sigurisë. Nëse kontraktori i propozuar nuk ka certifikatën e përshtatshme të sigurisë industriale, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës Palë mund të kërkojë që ai kontraktor të marrë leje sigurie.

2. Një klauzolë sigurie do të jetë pjesë përbërëse e çdo kontrate të klasifikuar ose nënkontrate, nëpërmjet të cilës kontraktori i Palës së origjinës specifikon se cili informacion i klasifikuar do t’i jepet ose gjenerohet nga Pala pritëse dhe cili nivel përkatës i klasifikimit të sigurisë i është caktuar këtij informacioni.

3. Detyrimet e kontraktorit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas një kontrate të klasifikuar u referohen, të paktën, sa më poshtë:

a) deklarimi i informacionit të klasifikuar ekskluzivisht personave që janë pajisur paraprakisht me lejen e përshtatshme të sigurisë së



personelit, të cilët kanë nevojë për njohje dhe që janë punësuar ose përfshirë në përmbushjen e kontratës;

b) transferimi i informacionit të klasifikuar me mjete sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

c) procedurat dhe mekanizmat e komunikimit të ndryshimeve që mund të lindin në lidhje me informacionin e klasifikuar, për shkak të ndryshimeve në nivelin e klasifikimit të sigurisë ose në rastin e deklasifikimit;

d) një detyrim për të njoftuar, në kohën e duhur, autoritetin kompetent të sigurisë së kontraktorit për një akses faktik, në tentativë, të dyshuar ose të paautorizuar në informacionin e klasifikuar të kontratës;

e) përdorimi i informacionit të klasifikuar sipas kontratës vetëm për qëllimet në lidhje me objektin e kontratës;

f) respektimi rigoroz i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me procedurat për trajtimin e informacionit të klasifikuar;

g) dhënia e informacionit sipas një kontrate të klasifikuar një Pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së origjinës.

4. Masat e kërkuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedura për vlerësimin dhe zhdëmtimin për humbje të mundshme të shkaktuara kontraktorëve nga aksesit i paautorizuar në informacionin e klasifikuar, specifikohet në më shumë hollësi në kontratën e klasifikuar përkatëse.

5. Kontrata e klasifikuar me nivelklasifikimi sigurie “I KUFIZUAR / RISERVATO / RESTRICTED” përmban një klauzolë të përshtatshme të sigurisë që identifikon masat minimale për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Certifikata e sigurisë industriale për këto kontrata nuk kërkohet por është e nevojshme që subjekti privat të caktojë një individ përgjegjës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “I KUFIZUAR / RISERVATO / RESTRICTED”, në pajtim me legjislacionet e tyre përkatëse të brendshme.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për nënkontratat.

#### Neni 11 Vizitat

1. Vizitat e kryera nga individët e një Pale të mjediset e Palës tjetër, të cilëve u duhet aksesit në

informacionin e klasifikuar i nënshtrohen autorizimit paraprak me shkrim nga autoriteti kompetent i sigurisë së Palës ku zhvillohet vizita.

2. Kërkesa për vizitë paraqitet të paktën 20 ditë para datës së planifikuar. Në rastin e vizitave urgjente të paplanifikuara më parë, kërkesa për vizitë paraqitet të paktën pesë ditë para zhvillimit të vizitës.

3. Kërkesa për vizitë përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës;

b) kombësinë/shtetësinë e vizitorit;

c) pozicionin e vizitorit dhe emrin e organizatës që përfaqëson;

d) certifikatën e sigurisë së personelit të vizitorit me nivelin e përshtatshëm të klasifikimit, sipas rastit;

e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;

f) emrin e organizatave dhe strukturave që kërkohen të vizitohen;

g) treguesin e pikës së kontaktit të subjekti publik apo privat që do të vizitohet, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, adresën e *e-mail*-it dhe numrin e telefonit.

5. Për vizitat e personelit të subjektit publik ose privat të një prej Palëve, deri te niveli “I KUFIZUAR/RISERVATO/RESTRICTED” bihet dakord drejtpërdrejt me subjektin publik ose privat të Palës tjetër. Subjekti publik ose privat pritës njofton autoritetin e vet kompetent për sigurinë në lidhje me vizitën.

6. Në rastin e projekteve ose kontratave që kërkojnë vizita periodike të klasifikuara si “KONFIDENCIAL/RISERVATISSIMO/CONFIDENTIAL” dhe më lart, autoritetet kompetente të sigurisë së Palëve njoftojnë me shkrim njëri-tjetrin duke dërguar një listë të personelit të autorizuar. Kjo listë nuk mund të jetë e vlefshme më shumë se 12 muaj.

7. Secila palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas legjislacionit përkatës të brendshëm.

#### Neni 12 Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e shkeljes së sigurisë, autoriteti kompetent i sigurisë, në shtetin e të cilit ka ndodhur shkelja e sigurisë, njofton me shkrim



autoritetin kompetent të sigurisë të Palës tjetër, në kohën e duhur dhe siguron hetim të përshtatshëm në pajtim me legjislacionet e brendshme. Pala tjetër, sipas rastit, bashkëpunon në hetim dhe informohet për rezultatet.

2. Në rast se shkelja e sigurisë ndodh në një Palë të tretë, autoriteti kompetent i sigurisë i Palës së origjinës ndërmerr të gjitha veprimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, sipas rastit.

#### Neni 13 **Shpenzimet**

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk përfshin asnjë shpenzim.

#### Neni 14 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet Palëve dhe nuk i paraqitet asnjë gjykatë ndërkombëtare apo një Palë të tretë.

2. Ndërkohë, Palët vazhdojnë të përmbushin dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje.

#### Neni 15 **Dispozita të fundit**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, që kërkesat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të denoncojë këtë Marrëveshje duke i bërë Palës tjetër njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje priset gjashtë (6) muaj nga data në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.

4. Në rastin e prishjes së kësaj Marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar, i transferuar në pajtim me këtë Marrëveshje, vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në të.

Bërë në Tiranë, më 9.12.2014, në dy kopje origjinale, secila në shqip, italisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.